



Republika e Kosovës - Republika Kosova
Komisioni Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborna komisija za žalbe i molbe

A Nr. 508/ 2009

Komisioni Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia, në panelin e përbërë nga Osman Tmava, kryesues, Ymer Hoxha, dhe Muharrem Shala, duke vendosur lidhur me ankesat e parashtruara për parregullsitë në procesin e votimit për raundin e dytë për zgjedhjen e kryetarëve të komunave të Prizrenit, Gjilanit dhe Lipjanit, në seancën e mbajtur më 19.12.2009, mori;

VENDIM

I. Pranohen të bazuara ankesat: A nr. 401; 402; 413; 414; 418; 421; 422; 423; 424; 425; 426; 427; 428; 429; 430; 431; 438; 440; 441; 442; 447; 448; 452; 453; 454; 455; 456; 457; 458; 459; 460; 482; 483; 484; 485; 488; 489; 497; 498; 499; 500; 501; 506.

II. Udhëzohet Komisionin Qendror Zgjedhor (KQZ) të urdhëroj përsëritjen e votimit në komunën e Prizrenit, Gjilanit dhe Lipjanit.

FAKTET

Pas ditës së zgjedhjeve për Kryetarë të Komunave të mbajtura më 13 Nëntor 2009 për raundin e II-të të zgjedhjeve, KZAP ka pranuar një numër të madh ankesash lidhur me mashtrimet gjatë zgjedhjeve, parregullsit dhe gabimet tjera gjatë votimit dhe numërimit në qendra të votimit dhe vendvotimeve të ndryshme.

Në Rregullat dhe Procedurat e KZAP-it, Neni 6.3 (Vendimet për ankesat) parasheh si vijon:

“Me qëllim të lehtësimit të shqyrtimit të ankesave, kryetari i Komisionit mund të vendos të bëjë konsolidimin e ankesave që ngërthejnë në vete çështje të ngjashme, dhe Komisioni i trajton ato ankesa sikurse të ishin një ankesë”.

Prandaj, KZAP do ti shqyrtoj dhe do të vendosë për të gjitha ankesat nga Komuna e Prizrenit, Gjilanit dhe Lipjanit me këtë vendim.

Po ashtu, KZAP-i ka pranuar një vendim nga KQZ më datë 16.12.2009 për anulim të rezultateve të Raundit të II-të të Zgjedhjeve për Kryetar të Komunave në disa vendvotimeve në lidhje me parregullsitë dhe mospërputhjet në mes të numrit të përgjithshëm të Fletëvotimeve të hedhura dhe Regjistrit të Votuesve në një

Vendvotim, mbi nivelin e tolerancës së paraparë me vendim të KQZ-së, fletëvotimeve me kusht të paidentifikuara, FLV-ve të VNV-ve pa zarfa të sigurisë si dhe nënshkrime të dyfishta, në Komunën e Prizrenit, Gjilanit dhe Lipjanit.

Prizren:

Për komunën e Prizrenit, KZAP ka pranuar ankesa në lidhje me parregullsitë serioze dhe/ose mashtrim zgjedhor të qëllimshëm, për 34 nga 60 qendra të votimit.

KZAP ka pranuar ankesa valide nga këto qendra votimi të specifikuar më poshtë:

QV: 2001A; 2002A; 2005X; 2009A; 2013A; 2014A; 2015A; 2016A; 2017A; 2018A; 2019A; 2021A; 2023A; 2024A; 2025A; 2026A 2027A; 2033A; 2034A; 2035A; 2036A; 2037A; 2038A; 2040A; 2041A; 2042A; 2051A; 2054A; 2059A; 2061A; 2065A; 2069A; 2067A; 2068A.

Gjatë hetimeve të tij në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve (QNR), KZAP ka zbuluar dëshmi të bazuara për parregullsi serioze dhe/ose mashtrim zgjedhor të qëllimshëm, në shumicën e këtyre ankesave.

Gjilan:

Për komunën e Gjilanit, KZAP ka pranuar ankesa në lidhje me parregullsitë serioze dhe/ose mashtrim zgjedhor të qëllimshëm, për 21 nga 31 qendra të votimit.

QV: 0401D; 0401X; 0402D; 0402X; 0404D; 0405D; 0406D; 0407D; 0408D; 0409D; 0410D; 04015D; 0421D; 0422D; 0428D; 0429D; 0437D; 0439D; 0440D; 0441D.

Gjatë hetimeve të tij në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve (QNR), KZAP ka zbuluar dëshmi të bazuara për parregullsi serioze dhe/ose mashtrim zgjedhor të qëllimshëm, në shumicën e këtyre ankesave.

Lipjan:

Për komunën e Lipjanit, KZAP ka pranuar ankesa në lidhje me parregullsitë serioze dhe/ose mashtrim zgjedhor të qëllimshëm, për 15 nga 26 qendra të votimit.

QV: 1303E; 1304E; 1305E; 1306E; 1307E; 1308E; 1316E 1322E; 1323E; 1325A; 1326E; 1327E; 1328E; 1329E; 1330E.

Gjatë hetimeve të tij në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve (QNR), KZAP ka zbuluar dëshmi të bazuara për parregullsi serioze dhe/ose mashtrim zgjedhor të qëllimshëm, në shumicën e këtyre ankesave.

ANALIZË

Juridiksioni i KZAP për shqyrtimin e ankesës buron nga kompetencat e dhëna nga Kuvendi i Republikës së Kosovës në Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme në

Republikën e Kosovës – LZP (Ligji nr – 03/073) dhe Ligjin për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës (Ligji nr 03/L-072).

Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës – LZP (Ligji nr – 03/073), Neni 120.1, pika b)(Përmirësimet dhe sanksionimet ndaj shkeljeve) parasheh si vijon:

b) *para certifikimit të rezultateve zgjedhore, dhe në rrethana të jashtëzakonshme është në zgjedhjen e vetë KZAP-it, për të anuluar rezultatet në një vendvotim apo të udhëzoj KQZ-në të urdhëroj përsëritjen e votimit në një qendër votimi.*

Po ashtu, Neni 106.2 (Rezultatet Zgjedhore), parasheh si vijon:

106.2 *Para certifikimit të rezultatit të zgjedhjeve, KQZ-ja mund të urdhërojë rinumërimin e votave në cilindo vendvotim, qendër të numërimit ose edhe përsëritjen e votimit në një qendër votimi apo në një komunë.*

Siç përcaktohet me lartë, LZP i ka mundësuar KZAP-it dy mjete juridike, kur shkelja serioze ka ndodhur dhe që rrezikon të minoj integritetin e zgjedhjeve. Asnjë mjet juridik nuk është ideal dhe secili mban reperkusionet e veta. Por i tillë është problemi me mashtrimet zgjedhore prandaj nuk është e mundur që të kthehet koha mbrapa dhe të ndreqen shkeljet sikur asgjë të mos kishte ndodhur.

Bazuar në rezultatet e hetimeve tona, KZAP ka përcaktuar se ka pasur mashtrime dhe vjedhje të mëdha të votave në këto tri komuna, prandaj udhëzimi i KQZ-së për të anuluar rezultatet të caktuara në disa vendvotime, do të ishte i pamjaftueshëm për të përmirësuar këto parregullsi dhe shkelje të ligjit.

KZAP konsideron se anulimi i rezultateve në një numër të konsideruar të vendvotimeve, do të ishte përgjigje jo adekuate për këto parregullsi dhe vjedhje masive. Së pari, anulimi i mbi 50% të vendvotimeve nuk do të shprehte plotësisht vullnetin e qytetarëve të këtyre komunave, sepse votat të mbetura nga këto vendvotime do të ishin në numër të vogël dhe si pasojë do të dëmtonte vullnetin e zgjedhësve të këtyre komunave dhe do të dëmtonte legjitimitetin e të zgjedhurve.

Së dyti, edhe nëse KZAP do të anulonte vendvotimet më problematike, për shkak të ngushtësisë së ndryshimit të rezultateve pre-eliminare, çdo anulim i tillë potencialisht do të bënte njërin kandidatë fitues. Jo vetëm që KZAP nuk do të konsideronte këtë zgjedhje të mirë, gjë që do të bënte një kandidat fitues por po ashtu duke konsideruar që janë një numër i konsideruar i mashtrimeve dhe parregullsive nga dy kampet e kandidatëve për kryetarë, pashmangshmërisht KZAP e vlerëson të gabueshme të shpërblej një subjekt politik me duar të papastërta. Duke ju referuar maksimës latine:

“Nemo ex dolo suo proprio relevetur aut auxillium capiat”. Le të mos fitoj askush dobi nga mashtrimet e tij.

Në këtë mënyrë, i vetmi mjet juridik që do të reflektonte në vullnetin e qytetarëve të këtyre komunave, do të ishte që të udhëzoj KQZ-në që të urdhëroj përsëritjen e votimit në këto tri komuna, si mjet i vetëm juridik i duhur në këto rrethana.

KZAP e kupton që edhe në vetëm disa komuna, përsëritja e votimit do të qonte drejt vonesave të konsiderueshme në certifikimin e rezultateve të zgjedhjeve në këto vende. Megjithatë, e drejta për të votuar dhe për të zgjedhur është ngushtë e lidhur me themelet e demokracisë, dhe si e tillë, mbrojtja e votës së lirë të sovranit mbi të gjitha është detyrim madhor dhe kusht për të reflektuar drejtë në vullnetin e çdo qytetari në Republikën e Kosovës.

KZAP nuk mendon që udhëzimi për rinumërim në këtë rast, ofron mjete efikase lidhur me shkëlqjen e ligjit për zgjedhjet. Andaj, KZAP rezervon të drejtën që të urdhëroj mjete të mëtejshme juridike lidhur me këto ankesa.


Për më tepër, KZAP-i rekomandon fuqishëm KQZ-në për qëllim të mbarëvajtjes së procesit të votimit, që gjatë ditës zgjedhjeve, të ndërmarrë masa në këto tri komuna:

- Të bëhet ndërrimi i komisionarëve të Qendrave të Votimit;
- Të shtohet prezenca e Policisë së Kosovës në të gjitha Qendrat e Votimit dhe;
- KQZ të shtoj mbikëqyrjen gjatë procesit të votimit.

Për këto arsye, bazuar në dispozitën e nenit 115.1 të LZP, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Komisioni Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa në Prishtinë

A nr. 508 /2009 më datën 19. 12.2009.





Republika e Kosovës - Republika Kosova
Komisioni Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës
Izborna komisija za žalbe i molbe

A nr. 426/2009

Komisioni Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës (KZAP), në panelin e përbërë nga Muharrem Shala, kryesues, Fahredin Ymeri dhe Imer Hoxha, anëtarë, duke vendosur përkitazi më ankesën e Lulzim Rustemi, në cilësinë koordinatorit të vëzhguesve nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), Smallushë komuna e Lipjanit, Qendra e Votimit (QV) 1330E01R, paraqitur kundër, Xhelal Krasniqi nga fshati Smallushë komuna e Lipjanit, në cilësinë e Kryesuesit të Vendvotimit (KVV), nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) dega ne Lipjan, për shkak të Frikësimit dhe Dhunës Gjatë Procesit Zgjedhor që ndalohet me nenin 34 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme ne Republikën e Kosovës (LZP), në seancën e panelit të mbajtur me 04.05.2010, mori këtë:

V E N D I M

Aprovohet ankesa si e bazuar.

I. Subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), është përgjegjës për shkeljen e nenit 34 paragrafët 1 dhe 2 të LZP-së, për çka i shqiptohet gjoba në shumë prej 4900 (katërmijë e nëntëqind) euro, të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 ditëve nga plotfuqishmëria e këtij vendimi, për tu dërguar pastaj në buxhetin e konsoliduar të Republikës së Kosovës

II. Xhelal Krasniqi i lindur në fshatin Smallushë komuna e Lipjanit, në cilësinë e Kryesuesit të Vendvotimit (KVV), nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) dega ne Lipjan, duke u bazuar ne nenin 120 paragrafi 3 pika d, të LZP-së, i ndalohet kandidimi ne zgjedhje për 4 (katër) vite si dhe i ndalohet pjesëmarrja aktive në procesin elektoral administrativ nën autoritetin e Komisionit Qendror Zgjedhor (KQZ) për 6 (gjashtë) vite, nga plotfuqishmëria e këtij vendimi.

A R S Y E T I M I

Lulzim Rustemi, në cilësinë koordinatorit të vëzhguesve nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), fshati Smallushë komuna e Lipjanit, Qendra e Votimit (QV) 1330E01R, ka parashtruar ankesë me te cilën pretendon se kryes i supozuar është Xhelal Krasniqi në cilësinë e Kryesuesit të Vendvotimit ngase gjatë gjithë ditës së zgjedhjeve ka pas parregullsi siç janë: shantazhe, kërcënime, votime të rrejshme në emër të votuesve që janë jashtë shtetit, në librin/listën e nënshkrimeve të votuesve. Po ashtu sipas parashtruesit të ankesës, Xhelal Krasniqi para komisionarëve dhe vëzhguesve ne Vendvotim ka nënshkruar në emër të votuesve fiktiv edhe pse janë bërë vërejtje nga komisionarët e subjekteve tjera politike nga siç janë në këtë rast; PDK-ja, Aleanca Kosova e Re (AKR) dhe Partia e Drejtësisë (PD).

Parashtruesit i ankesës propozon që pretendimet ankimore të aprovohen si të bazuara, të anulohet rezultati i Zgjedhjeve Komunale rundi i dytë për pozitën e Kryetarit të Komunës së Lipjanit, QV 1330E/01R.

F A K T E T

Më 15 Dhjetor 2009, KZAP-i, ka pranuar një ankesë nga Lulzim Rustemi, në cilësinë koordinatorit të vëzhguesve nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), fshati

Smallushë komuna e Lipjanit, Qendra e Votimit (QV) 1330E01R, me të cilën pretendon se Xhelal Krasniqi në cilësinë e Kryesuesit të Vendvotimit ka bërë shkelje esenciale të LZP-së, duke i shantazhuar, kërcënuar, votime të rrejshme në emër të votuesve që janë jashtë shtetit, në librin/listën e nënshkrimeve të votuesve Xhelal Krasniqi para komisionarëve dhe vëzhguesve në Vendvotim ka nënshkruar në emër të votuesve fiktiv.

Deklaratat e dëshmitarëve që kanë qenë në cilësinë e komisionarëve gjatë ditës së zgjedhjeve nga subjekte të ndryshme politike:

Ramadan Sopa, në cilësinë e komisionarit të subjektit politik PD, në QV 1330E/01R, deklaroi se: “me presion e kam nënshkruar procesverbalin ngase kam qenë i pa mbrojtur kur më janë afruar Xhelal Krasniqi, Hajrush Thaçi, Reshat Krasniqi dhe Nevzat Kraniqi, të cilët kanë kërkuar nga komisionari i PD-së të nënshkruhet Procesverbali i Listës Përfundimtare”. nga kjo del se nga frika e ka nënshkruar këtë procesverbal. Mëtej komisionari i PD-së, thekson në deklaratën e tij se numri i nënshkrimeve që të bëhet barazimi kryesuesi i Vendvotimit Xhelal Krasniqi me dorë të vetë publikisht ka nënshkruar në listën e nënshkrimeve.

Servete Thaçi, në cilësinë e menaxheres së QV nr. 1330E/01R ka deklaruar se: kryesuesi i qendrës 01R Xhelal Krasniqi, është sjellë në mënyrë arrogante më menaxheren e kësaj qendre sa që ka përdorë edhe fjalë ofenduese, në Qendrën 01R të gjithë ishin familjar të kryesuesit së kësaj gjë që e kamë lajmëruar Komisionin Qendror Zgjedhor (KQZ) në Lipjan. Të gjitha parregullsitë e shkaktuar në këtë qendër janë të lajmëruar në Polici.

Tefik Pacolli, në cilësinë e komisionarit nga subjekti politik AKR, në QV nr. 1330E/01R ka deklaruar se: gjatë ditës është bërë manipulim i votave, në mbrëmje ende pa u mbyllur kutia është prerë shiriti dhe janë derdhur votat për tu numëruar. Komisionari i subjektit politik AKR në deklaratën e tij mëtej thekson se nuk e kamë nënshkruar listën ndërsa thuhet se në vendin tim ku kam pas të nënshkruaj figuron nënshkrimi im, e ka parë duke nënshkruar listën e nënshkrimeve nga Xhelal Krasniqi dhe Hajrush Thaçi mbi tridhjetë (30) nënshkrime në listën e nënshkrimeve.

Në Kallëzimin Penal të Policisë së Kosovës , nr. 2009-AH-1450 thuhet se: “Sipas Dëshmitarëve Xhelal Krasniqi e ka marrë librin e nënshkrimeve dhe ka filluar vet të qes nënshkrime në atë libër, ku kanë reaguar disa prej komisionarëve.

Komisionari i PDK-së, e ka plotësuar formularin e ankesave ku njeherit edhe komisionarët tjerë e kanë plotësuar formularin e ankesave, këtë formular e ka mbushur edhe Gëzim Neziri i Demokracisë në Veprim, këtë formular e ka marrë dhe e ka lexuar kryesuesi Xhelal Krasniqi ku pastaj e ka shqyer në prezencën e komisionarëve me arsyetim se ankesat e tij duhet ti paraqes në organizatën ku ai e përfaqëson”.

Kallëzimi Penal, nr. 2009-AF-1693 datë 18.12.2009 është dorëzuar në Prokurorinë Publike Komunale në Prishtinë me datë 11.02.2010, për shkak të dyshimit të bazuar se kryesuesi i qendrës së votimit Xhelal Krasniqi ka kryer veprën penale Mashtrim në Votime neni 180 paragrafi 1 të KPPK-së.

KZAP-i, informoi LDK-në më 23.04.2010 rreth ankesës dhe i dha mundësin të përgjigjej duke u bazuar në nenin 4 paragrafi 3 të Rregullores së Punës të KZAP-it. KZAP-i më 27.04.2010, mori përgjigjeje në ankesë nga subjekti politik LDK, në të cilën theksohet se: formularin e përputhjes e kanë nënshkruar 5 anëtarët e Këshillit të Vendvotimit, nuk është nënshkruar nga anëtari i PDK-së, i cili për çdo gjë është pajtuar deri në momentin e përfundimit të numërimit kur është parë se kandidati i LDK-së Imri Ahmeti ka fituar bindshëm. Nuk është e vërtet se Xhelal Krasniqi, ka vënë nënshkrime në Listën e Votuesve për persona të cilët nuk kanë marrë pjesë në votim apo të ketë ushtruar presion ndonjërit prej anëtarëve të KVV-së për ta nënshkruar Formularin e Përputhjes së Rezultateve. Si provë përgjigjes në ankesë ia ka bashkangjitur deklaratën me shkrim të Xhelal Krasniqit dhe kopjen e Formularit për Përputhjen e Rezultateve.

ANALIZË

Juridiksioni i KZAP-it lidhur me ankesat është caktuar në pajtim me kompetencat e dhëna nga Kuvendi i Republikës së Kosovës në *Ligjin mbi Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës – LZP* (Ligji nr 03/L- 073) dhe *Ligjin për Zgjedhjet Lokale në Republikën Kosovës* (Ligji nr 03 / L-072).

KREU -V- i LZP-së KODI I MIRËSJELLJES PËR SUBJEKTET POLITIKE, MBËSHTETËSIT E TYRE DHE KANDIDATËT

Në Nenin 38 paragrafi 1, përcaktohet se:

Shkelja e njërit nga këto nene të Kodit të Sjelljes të paraqitur në këtë Kapitull, në rastet kur këto shkelje nuk kanë ndikuar në rezultatet e zgjedhjeve, konsiderohet shkelje administrative dhe e dënueshme me gjobë sikurse është përcaktuar nga KZAP-i.

LZP- neni 120 paragrafi 3 pika d parasheh:

Që të ndalojë një individ të marrë pjesë në zgjedhjet e mbajtura nën autoritetin e KQZ-së si kandidatë apo edhe si pjesë administrative e ndonjë organi zgjedhor, për një periudhë kohore që nuk i kalon gjatshë (6) vite

Duke vendosur për gjobën që do të vihet në këtë lëndë, KZAP-i, ka marrë si rrethanë rënduese, se shkelja ka të bëjë me veprimet e ndaluara të parapara në nenin 34 paragrafi 1 dhe 2 të LZP-së, Frikësimit dhe Dhunës Gjatë Procesit Zgjedhor.

KZAP-i, sa i përket ndalimit për pjesëmarrje në zgjedhje si rrethanë rënduese ka marrë se ekziston dyshimi se ka kryer vepër penale Mashtrim në Votime neni 180 paragrafi 1 të KPPK-së po ashtu i njëjti ka qenë i vetëdijshëm se veprimi i tillë është i ndaluar sepse ka qenë edhe kryesues i QV.

KZAP-i, ka konstatuar se provat që janë bashkangjitur përgjigjes në ankesë nga subjekti politik LDK, nuk janë të asaj natyre juridike që do të kenë ndikim në vendimmarrje.

Për këto arsye, bazuar në dispozitën e nenit 115.1 të LZP, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Komisioni Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës në Prishtinë

A nr. 426/2009 më datën 04.05.2010

Kryesuesi i Panelit
Muharrëm Shala

